**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA VAU DEJËS**

---

Nr.4462 Prot                                                    Vau Dejës, më 18.07.2023

**Lënda:** **Kërkesë për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimi.**

**KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS**

**Të nderuar këshilltarë,**

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimin për *"Miratimin e shtesës së planit në buxhetin e bashkisë Vau Dejës për vitin 2023*" *për Bashkinë Vau Dejës"*

Duke ju uruar punë të mbarë!

**KRYETAR**

**Kristian SHKRELI**

---

*Adresa: Rruga" Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006,* ***ëeb:*** *ëëë.vaudejes.gov.al,* ***e-mail:*** *info@vaudejes.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETAR

Nr._____ Prot

Vau Dejës, më ____.____.2023

## PROJEKT VENDIM

**Nr.05, datë 18.07.2023**

**PËR**

## "MIRATIMIN E SHTESËS SË PLANIT NË BUXHETIN E BASHKISË VAU DEJËS PËR VITIN 2023"

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 27.07.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54 shkronja "dh", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të ligjit nr 68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, Udhëzimin te Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 "Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, Udhëzimit plotësues nr 2, datë 19.01.2023 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023", VKB nr 84 datë 23.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Vau Dejës, dhe me shkresë nr 24/1 dt 12.01.2023 të miratuar nga Prefektura Shkodër, VKM nr 328 datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", sipas shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 12674 datë 10.07.2023 "Dërgohet akordimi i fondit për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr.328, datë 31.5.2023", dhe sipas relacionit te përgatitur nga Administrata e Bashkisë:

**V E N D O S A:**

1. Miratimin e shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës për vitin 2023, sipas Formatit Nr 1:

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

**K R Y E T A R**

**Kristian SHKRELI**

*Zv. Kryetar*

Mark Zheri

*Drejtoria e Burimeve Njerëzore*

*Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar*

Elsa Pepa

*Drejtoria Juridike e Integrimit Prokurimeve dhe Aseteve*

Bib Mirizi

**Institucioni: Bashkia Vau Dejës**

Formati Nr. 1 Rishperndarje e planit te pagave sipas shkreses nr 12674 datë 10.07.2023 te Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Dërgohet akordimi I fondit për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr.328, datë 31.5.2023"

**PAKESOHET**

*Në Lekë*

| Entit.i Qev. | Min.e Linjes | Kod Instit. | Kap. | Programi | Kod Produkti | Llog. Ekon. | Kodi I Deges se Thesarit | Debiti | Emer Instititucioni |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 157 | 00 | 2157001 | 01 | 4960 | 90005AA | 6040000 | 3333 | 12,547,584.00 | Bashkia Vau-Dejes |
| **SHUMA** | | | | | | | | **12,547,584.00** | |

**SHTOHET**

Në Lekë

| Entit.i Qev. | Min.e Linjes | Kod Instit. | Kap. | Programi | Kod Produkti | Llog. Ekon. | Kodi I Deges se Thesarit | Debiti | Emer Instititucioni |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 157 | 00 | 2157001 | 01 | 01110 | 9999999 | 6000000 | 3333 | 7,111,125.00 | Bashkia Vau-Dejes |
| 157 | 00 | 2157001 | 01 | 01110 | 9999999 | 6010000 | 3333 | 1,146,977.00 | Bashkia Vau-Dejes |
| 157 | 00 | 2157001 | 01 | 04240 | 9999999 | 6000000 | 3333 | 864,000.00 | Bashkia Vau-Dejes |
| 157 | 00 | 2157001 | 01 | 04240 | 9999999 | 6010000 | 3333 | 144,288.00 | Bashkia Vau-Dejes |
| 157 | 00 | 2157001 | 01 | 04260 | 9999999 | 6000000 | 3333 | 274,128.00 | Bashkia Vau-Dejes |
| 157 | 00 | 2157001 | 01 | 04260 | 9999999 | 6010000 | 3333 | 35,070.00 | Bashkia Vau-Dejes |
| 157 | 00 | 2157001 | 01 | 04520 | 9999999 | 6000000 | 3333 | 594,000.00 | Bashkia Vau-Dejes |
| 157 | 00 | 2157001 | 01 | 04520 | 9999999 | 6010000 | 3333 | 99,198.00 | Bashkia Vau-Dejes |
| 157 | 00 | 2157001 | 01 | 06260 | 9999999 | 6000000 | 3333 | 1,952,900.00 | Bashkia Vau-Dejes |
| 157 | 00 | 2157001 | 01 | 06260 | 9999999 | 6010000 | 3333 | 325,898.00 | Bashkia Vau-Dejes |
| **SHUMA** | | | | | | | | **12,547,584.00** | |

**Nëpunësi Zbatues**

**Elsa Tanushi**

**Nëpunësi Autorizues**

**Kristian Shkreli**

NR. 1352 Prot.
16.07.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE

Nr. 12674 Prot.

Tiranë, më 10. 07. 2023

**Lënda:** Dërgohet akordimi i fondit për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr.328, datë 31.5.2023.

**BASHKISË** VAU DEJËS

**KËSHILLIT TË QARKUT** ____________

**DEGËS SË THESARIT**________________

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT**

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.328 datë 31.5.2023 *"Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore"*, ju dërgojmë detajimin e fondeve që akordohen për rritjen e pagave për vitin 2023, sipas tabelës bashkëlidhur.

Referuar kërkesave të bashkive lidhur me fondet e nevojshme për rritjen e pagave deri në fund të vitit 2023, sqarojmë se fondet e kontigjencës për vitin 2023 sipas pikës 15, a) të VKM 328/2023, mbulojnë vetëm rritjen e kufirit minimal, ndërkohë që efektet financiare të rritjes së pagave sipas pikës 15, b) të VKM 328/2023, VKM nr.113, datë 1.3.2023 *"Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"* dhe VKM nr.326 datë 31.5.2023 *"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike"* përballohen nga fondet dhe të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Risena Xhaja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

*në lekë*

| Ent Qev | Min Linj | Kod Institucioni | Emër Institucioni | Kapitulli | Programi | Kod produkti | Llogari ekonomike | Kodi i Degës së Thesarit | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 157 | 00 | 2157001 | Bashkia Vau i Dejes | 01 | 04960 | 90005AA | 6040000 | 3333 | 12,547,584 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA EKONOMIKE DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS

# RELACION

# PËR

# "MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NIVELIT TË PAGAVE PËR FUNKSIONARËT E ZGJEDHUR E TË EMËRUAR, NËPUNËSIT CIVIL DHE PUNONJËSIT ADMINISTRATIV TË BASHKISË VAU DEJËS PËR VITIN 2023"

Sipas Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023 për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore.

**Ndryshimi i nivelit të pagave për punonjësit e Bashkisë Vau Dejës për vitin 2023:**

- **Sipas lidhjes nr 1: Administrata e Bashkisë:**

Paga e Kryetarit të Bashkisë rritet me 19,275 lekë

Paga e Nënkryetarit të Bashkisë rritet me 23,350 lekë

Paga e Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë rritet me 6,000 lekë

Paga e Sekretarit të Keshillit rritet me 5,200 lekë

Paga e Drejtorit rritet me 5,200 lekë

Paga e Këshilltarit të Kryetarit rritet me 4,800 lekë

Administratori i Njësisë Bushat (20001-50000) rritet me 10,000 lekë

Administratori i Njësisë Hajmel (5001-20000) rritet me 10,000 lekë

Administratori i Njësisë Vig Mnelë (deri-5000) rritet me 20,000 lekë

Administratori i Njësisë Shllak (deri-5000) rritet me 20,000 lekë

Administratori i Njësisë Temal (deri-5000) rritet me 20,000 lekë

Paga e K/Inspektor të IVM-të rritet me 5,200 lekë

Paga e Inspektoit të IVM-të rritet me 4,000 lekë

Paga e Përgjegjësit rritet me 4,800 lekë

Paga e Specialistit rritet me 4,000 lekë

Paga e Specialistit sipas pikës 11 rritet me 5,300 lekë

- **Sipas lidhjes nr 2: Struktura e punonjësve të "Qendrës Sociale Multifunksionale Rezidenciale "Besa" Barbullush":**

Paga e Përgjegjësit të "Qendrës Sociale" Multifunksionale Rezidenciale "Besa Barbullush" rritet me 4,800 lekë

Paga e Specialistit të Shërbimit Social rritet me 4,000 lekë

Paga e Psikologut rritet me 4,000 lekë

**Konceptoi:**
Avenida Heta

**Miratoi:**
Elsa Tanushi

**KRYETARI**

Kristian Shkreli

Adresa: Rruga" Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006,**ëeb:** ëëë.vaudejes.gov.al, **e-mail:** info@vaudejes.gov.al